



Duke u bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032 dhe në Ligjin për Arsimin dhe Aftësimin Profesional dhe në Udhëzimin Administrativ Nr.22/2013 për Numrin maksimal të nxënësve për klasë dhe raportin mësimdhënës nxënës, Drejtoria Komunale e Arsimit në Rahovec shpall:

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Arsim
Odeljenje za Obrazovanje
-IV- Nr. l prot. 886 Br. prot. Më Dt. 23.08.2021
RAHOVEC - ORAHOVAC

KONKURS (plotësues)

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) NË SHKOLLAT E MESME TË LARTA TË KOMUNËS SË RAHOVECIT PËR VITIN SHKOLLOR 2021/2022

(afati i gushtit)

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, në gjimnaze dhe IAAP, për vitin shkollor 2021/22, mund të konkurojnë nxënësit, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit, të cilët e kanë përfunduar klasën e 9-të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHTI dhe më pastaj të konkurojnë për regjistrim.

2. Dokumentet e nevojshme për konkurim

Nxënësit për të konkuruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaze dhe në IAAP, duhet të paraqesin këto dokumente:

- Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkuron)
- Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe
- Certifikatën e lindjes.

3. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për gjimnaze dhe IAAP për vitin shkollor 2021/2022, bëhet në datat, 23, 24 dhe 25 gusht 2021 në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora 8.00-16.00.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën, 26.08.2021.

Nxënësi i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë, brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i parashtrij ankesë drejtorisë së shkollës, Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe në raste të jashtëzakonshme komisionit për ankesa në MASHTI.

A. Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kriteret:

1. Suksesi nga shkollimi i obliguar (40%) 40 pikë
2. Suksesi nga lëndët prioritare (20%) 20 pikë
3. Numri i pikëve nga testi (40%) 40 pikë

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë 100 pikë

Kriteri i lëndëve prioritare nga sukcesi për gjimnaze dhe shkollat e mesme të mjekësisë është që mesatarja e këtyre lëndëve të jetë 4 (së pari llogaritet mesatarja e lëndëve veç e veç, pastaj mesatarja e mesatareve të atyre lëndëve).

Kriteri i lëndëve prioritare nga testi për gjimnaze dhe shkolla të mesme të mjekësisë është minimumi i 40% i pikëve në ato lëndë.

1. Nxënësi nga sukcesi i përgjithshëm i shkollimit të të obligueshëm (kl. 6,7,8,9) mund t'i fitojë maksimalisht 40 pikë.

Formula për llogaritjen e pikëve të suksesit është:

- Nxënësi nga sukcesi i përgjithshëm i lëndëve prioritare, maksimalisht mund t'i fitojë 20 pikë
- Lëndët me prioritet në sukses sipas drejtimeve të gjimnazeve
 - a. Gjmnazi i shkencave natyrore: Fizikë , Kimi, Biologji, Matematikë.
 - b. Gjmnazi i shkencave shoqërore dhe gjuhësore: Gjuhë amtare, Gjuhë angleze, Histori, Gjeografi.

Lëndët me prioritet në sukses sipas profileve të IAAP

- a. **Shëndetësi, Bujqësi, Teknologji Ushqimore dhe Veterinari:** Gjuhë Shqipe dhe letërsi, Biologji, Kimi, Fizikë.
- b. **Makineri, Elektroteknikë, TIK, Tekstil, Gjeodezi, Ndërtimtari, Xehetari, Gjeologji, Grafikë, Komunikacion, Kimi-teknologji, PTT:** Gjuhë shqipe dhe letërsi, Matematikë, Fizikë, Gjuhë Angleze.
- c. **Juridik dhe Administratë:** Gjuhë shqipe dhe letërsi, Edukatë qytetare, Histori, Gjuhë angleze.
- d. **Tregëti, Hoteleri dhe Turizëm:** Gjuhë shqipe dhe Gjuhë angleze, Shkenca shoqërore, Matematikë dhe informatikë, Shkenca natyrore.

3. Kriteri i suksesit të notave në lëndët prioritare për drejtimet përkatëse:

- **Gjmnazi i shkencave natyrore-** Mesatarja e lëndëve: Fizikë, Kimi, Biologji dhe Matematikë së paku duhet të jetë 4 (katër), si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në testë (10 pikë nga lëndët fizikë, kimi dhe biologji).
- **Gjmnazi i shkencave shoqërore dhe gjuhësore-** Mesatarja e lëndëve: Gjuhë shqipe, Gjuhë angleze, Histori, gjeografi së paku duhet të jetë 4 (katër) si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test (10 pikë nga lëndët histori, gjeografi).
- **Shkollat e shëndetësisë-** Mesatarja e lëndëve: Gjuhë shqipe dhe letërsi, Biologji, Kimi, Fizikë, nota së paku duhet të jetë 4 (katër), si dhe 40% e pikëve nga lëndët prioritare në test (1 pikë nga lëndët: Gjuhë shqipe dhe letërsi, Biologji, Kimi, Fizikë).

B. Përbajtja e testit- numri i kërkesave (pyetjeve) sipas lëndëve:

I. Gjuhë

- | | | |
|------------------|---------|--------------------|
| 1. Gjuhë shqipe | 20 pikë | |
| 2. Gjuhë angleze | 5 pikë | (Gjithsej 25 pikë) |

II. Shkencat shoqërore

- | | | |
|--------------|---------|--------------------|
| 1. Gjeografi | 12 pikë | |
| 2. Histori | 13 pikë | (Gjithsej 25 pikë) |

III. Matematikë

- | | | |
|----------------|---------|---------------------|
| 1. Matematikë | 20 pikë | |
| 2. Informatikë | 5 pikë | (Gjithsej 25 pikë) |

IV. Shkencat natyrore

- | | | |
|-------------|--------|--------------------|
| 1. Fizikë | 8 pikë | |
| 2. Kimi | 8 pikë | |
| 3. Biologji | 9 pikë | (Gjithsej 25 pikë) |

4. Renditja e lëndëve me prioritet në test sipas drejtimeve të gjimnazeve:

I. Gjimnazi shkencat e natyrës:

- | | | |
|-----------------------------------|----|----------------------------|
| 1. Shkencat e natyrës | 25 | $25 \times 0.8 = 20$ pikë |
| 2. Matematikë dhe Informatikë | 25 | $25 \times 0.4 = 10$ pikë |
| 3. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze | 25 | $25 \times 0.3 = 7.5$ pikë |
| 4. Shkencat shoqërore | 25 | $25 \times 0.1 = 2.5$ pikë |
| | | Totali = 40 pikë |

II. Gjimnazi shoqëror gjuhësor:

- | | | |
|-----------------------------------|----|----------------------------|
| 1. Shkencat shoqërore | 25 | $25 \times 0.8 = 20$ pikë |
| 2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze | 25 | $25 \times 0.4 = 10$ pikë |
| 3. Matematikë dhe Informatikë | 25 | $25 \times 0.3 = 7.5$ pikë |
| 4. Shkenca natyrore | 25 | $25 \times 0.1 = 2.5$ pikë |
| | | Totali = 40 pikë |

1. Renditja e lëndëve me prioritet sipas profileve në IAAP

I. Shëndetësi, Bujqësi dhe Veterinari:

- | | | |
|---|----|----------------------------|
| 1. Gjuhë shqipe dhe letërsi dhe gjuhë angleze | 25 | $25 \times 0.8 = 20$ pikë |
| 2. Shkenca e natyrës | 25 | $25 \times 0.4 = 10$ pikë |
| 3. Matematikë dhe Informatikë | 25 | $25 \times 0.3 = 7.5$ pikë |
| 4. Shkencat shoqërore | 25 | $25 \times 0.1 = 2.5$ pikë |
| | | Totali = 40 pikë |

II. Makineri, Elektroteknikë, Gjeodezi, Ndërtimtari, Xehetari, Gjeologji. Grafikë dhe Komunikacion, Kimi-Teknologji

- | | | |
|---|----|----------------------------|
| 1. Gjuhë shqipe dhe letërsi dhe Gjuhë angleze | 25 | $25 \times 0.8 = 20$ pikë |
| 2. Matematikë dhe informatikë | 25 | $25 \times 0.4 = 10$ pikë |
| 3. Shkenca shoqërore | 25 | $25 \times 0.3 = 7.5$ pikë |
| 4. Shkenca natyrore | 25 | $25 \times 0.1 = 2.5$ pikë |
| | | Totali = 40 pikë |

III. Ekonomi

- | | | |
|---|----|----------------------------|
| 1. Gjuhë shqipe dhe letërsi dhe Gjuhë angleze | 25 | $25 \times 0.8 = 20$ pikë |
| 2. Matematikë dhe informatikë | 25 | $25 \times 0.4 = 10$ pikë |
| 3. Shkenca shoqërore | 25 | $25 \times 0.3 = 7.5$ pikë |
| 4. Shkenca natyrore | 25 | $25 \times 0.1 = 2.5$ pikë |
| | | Totali = 40 pikë |

IV. Juridik

- | | | |
|---|----|----------------------------|
| 1. Gjuhë shqipe dhe letërsi dhe Gjuhë angleze | 25 | $25 \times 0.8 = 20$ pikë |
| 2. Shkenca shoqërore | 25 | $25 \times 0.4 = 10$ pikë |
| 3. Matematikë dhe informatikë | 25 | $25 \times 0.3 = 7.5$ pikë |
| 4. Shkenca natyrore | 25 | $25 \times 0.1 = 2.5$ pikë |
| | | Totali = 40 pikë |

V. Tregëti, Hoteleri dhe Turizëm

- | | | |
|---|----|----------------------------|
| 1. Gjuhë shqipe dhe letërsi dhe Gjuhë angleze | 25 | $25 \times 0.8 = 20$ pikë |
| 2. Shkenca shoqërore | 25 | $25 \times 0.4 = 10$ pikë |
| 3. Shkenca natyrore | 25 | $25 \times 0.3 = 7.5$ pikë |
| 4. Matematikë informatikë | 25 | $25 \times 0.1 = 2.5$ pikë |
| | | Totali = 40 pikë |

**PLANIFIKIMI I REGJISTRIMIT TË NXËNËSVE NË KLASAT E (10-të) PËR VITIN
SHKOLLOR 2021/22, AFATI I GUSHTIT**

Nr.	Emri i shkollës	Vendi	Drejtimi	Numri i paraleleve	Nr. i nxënësve në klasë	Gjithësej nr. i nxënësve
1	SHML"Xhelal Hajda-Toni	Rahovec	Gjimnazi i Shkencave Natyrore	3	32	96
			Gjimnazi i Shkencave Shoqërore	2	32	55
			Gjithësej	5		151

Nr.	Emri i shkollës	Vendi	Drejtimi	Numri i paraleleve	Nr. i nxënësve në klasë	Gjithësej nr. i nxënësve
2	SHML"Ukshin Hoti"	Krushë e Madhe	Gjimnazi i Shkencave Natyrore	2	32	64
			Gjimnazi i Shkencave Shoqërore	2	2	64
			Makineri: Automekanik 1	1	28	28
			Gjithësej	5		156

Nr.	Emri i shkollës	Vendi	Drejtimi	Numri i paraleleve	Nr. i nxënësve në klasë	Gjithësej nr. i nxënësve
3	SHML"12 Maji"	Ratkoc	Gjimnazi i Shkencave Natyrore	2	32	64
			Gjimnazi i Shkencave Shoqërore	2	2	64
			Gjithësej	4		128


Nr.	Emri i shkollës	Vendi	Drejtimi	Numri i	Nr. i	Gjithësej nr.
-----	-----------------	-------	----------	---------	-------	---------------

			paralele ve	nxënësve në klasë	i nxënësve	
4	SHMLP"Selajdin Mullaabazi-Mici"	Rahovec	Ekonomi: Kontabilitet dhe tatime-1	1	28	7
			Hoteleri: Asistent i Gastronomisë- 1	1	28	28
			Juridik : Asistent i Administratës 1	1	28	5
			Makineri: Instalues i ngrohjes qendrore, klimatizimit dhe ujësjellësit 1	1	28	22
			Bujqësi: Agrobiznes 1	1	28	28
			Mjekësi: Bashkëpunëtor profesional i Infirmierisë-1	1	25	25
			Elektroteknikë: Informatikë 1	1	28	17
			Ndërtimtari: Ndërtimtari 1	1	28	28
			Teknologji Ushqimore: Përpunimi i produkteve ushqimore 1	1	28	25
		Gjithësej:	9		185	

Gjithësej për komunën e Rahovecit	23		618
--	-----------	--	------------

Rahovec më:

23.08.2021



Avni Morina, Drejtor

Avni Morina